



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

VENDIM

Nr. 40 Datë 09.09 . 2025


PËR

MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR BARAZINË GJINORE 2026-2028

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projektvendimin dhe relacionin e paraqitur nga kryetari i bashkisë, si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Vendimit nr. 400, datë 30.6.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimit" Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligji Nr. 125/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, Ligji Nr. 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, Ligji Nr. 35/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 136/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", Ligji Nr.104/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar , Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji Nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e femijës", Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, Ligji Nr. 75/2019 "Për rininë" i ndryshuar, Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në jetën vendore ,

VENDOSI

1. Të miratojë Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2026-2028, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social dhe Kujdesit Shoqëror, si dhe Koordinatori për të drejtën e informimit dhe barazinë gjinore.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.



Votimi: Pro19, Kundër 0 Abstenim 0



PLANI VENDOR I BARAZISË GJINORE

2026-2028

BASHKIA KUKËS

Tabela e përmbajtjes

Parathënie.....	2
Falënderime.....	3
Kuadri ligjor dhe institucional si dhe lidhja me dokumentet strategjike	4
Analiza e situatës gjinore ne territorin e bashkisë	6
Demografia	7
Analfabetizmi.....	9
Niveli Arsimor	10
Statusi martesor.....	12
Statusi i nënës	14
Frekuentimi i çerdhes.....	16
Frekuentimi i Kopshtit	18
Persona me Aftësi të Kufizuar	19
Metodologjia	22
Vizioni dhe objektivat strategjike	24
Qëllimet dhe objektivat strategjike	25
Qëllimi Strategjik 1 (Q1):	25
Qëllimi Strategjik 2 (Q2):	26
Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)	27
Qëllimi strategjik 1:	28
Objektivi Specifik (O1.1).....	28
Objektivi Specifik (O1.2).....	30
Objektivi Specifik (O1.3).....	31
Qëllimi strategjik 2:	32
Objektivi Specifik (O2.1).....	32
Objektivi Specifik (O2.2).....	33
Objektivi Specifik (O2.3).....	35
Objektivi Specifik (O2.4).....	36
Monitorimi dhe raportimi	37

Parathënie

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave kanë qenë prej kohësh objektiva të rëndësishëm. Për të avancuar më tej në përmbushjen e tyre në mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme, duke integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe programet vendore, kemi hartuar Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2026–2028.

Ky dokument strategjik është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, të zhvilluar me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të drejtuesve e specialistëve të bashkisë dhe njësive administrative, përfaqësuesve të komunitetit, institucioneve arsimore, shëndetësore, organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve të Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë me mbështetjen teknike të Smart Processes.

Plani vendor për barazinë gjinore 2026 – 2028 bazohet në analizën e nevojave vendore dhe përvojës nga zbatimi i politikave të mëparshme, duke marrë në konsideratë praktikatat më të mira dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore.

Në këtë plan janë parashikuar masa të qarta për promovimin e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në vendimmarrje, fuqizimin e tyre ekonomik dhe social, promovimin e barazisë gjinore midis grave dhe burrave, përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbime për gratë e burrat, si dhe për adresimin e dhunës me bazë gjinore në komunitetin tonë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar grupeve më të cënuara, si gratë në zonat rurale, vajzat e reja, gratë me aftësi të kufizuara apo ato që kanë përjetuar dhunë.

Bashkia mbetet e përkushtuar për të ndërtuar një shoqëri të drejtë, ku askush nuk mbetet pas dhe ku të drejtat e çdo individi respektohen e garantohen. Ne besojmë se për të arritur këtë vizion, është e nevojshme një përpjekje e përbashkët dhe një bashkëpunim i ngushtë me të gjithë aktorët e shoqërisë. Prandaj, ftojmë të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat të bëhen pjesë aktive e zbatimit të këtij plani.

Angazhimi ynë, drejt një Bashkie më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse!

Falënderime

Bashkia Kukës shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë (SHKBSH) dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë Këshillin Bashkiak të Kukësit, i cili ka mbështetur këtë proces nëpërmjet angazhimit të Komisionit për Barazinë Gjinore dhe Aleancës së Grave Këshilltare, duke siguruar një qasje të hapur dhe gjithëpërfshirëse në hartimin e planit.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive e sektorëve vendorë, organizatave të shoqërisë civile, grupeve komunitare dhe partnerëve lokalë që morën pjesë aktivisht në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e nevojave të vërteta të komunitetit.

Kuadri ligjor dhe institucional si dhe lidhja me dokumentet strategjike

Në nivel lokal, kuadri ligjor dhe institucional që udhëheq përpjekjet për barazinë gjinore në Bashki ndërtohet mbi bazën e parimeve dhe detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18/2, garanton barazinë para ligjit dhe ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë dhe faktorëve të tjerë.

Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”: Ky ligj përcakton parimet themelore të trajtimit të barabartë të grave dhe burrave dhe promovon pjesëmarrjen e tyre në të gjitha fushat e jetës publike. Ai parashikon gjithashtu detyrimin për mbledhjen e statistikave gjinore dhe krijimin e mekanizmave për zbatimin e politikave gjinore në nivel vendor.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”: Ky ligj i njeh bashkive një rol kyç në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore. Neni 6 i këtij ligji përcakton se njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Neni 62 u kërkon bashkive të respektojnë parimin e barazisë gjinore në emërimet në pozita drejtuese si nënkryetarë bashkie dhe administratorë njësisht.

Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”: Ky ligj krijon bazën për përfshirjen e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit buxhetor vendor. Ai kërkon që ndarja dhe përdorimi i fondeve të buxhetit të orientohen drejt garantimit të të drejtave dhe mundësive të barabarta për gra dhe burra, si dhe ofron fleksibilitet për të financuar politika që adresojnë nevojat gjinore.

Ligji nr. 57/2016 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, përfshin për herë të parë konceptin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si një nga parimet e sistemit buxhetor. Kjo mbështet integrimin gjinor në planifikimin dhe menaxhimin financiar vendor.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili përcakton detyrimet e bashkive për krijimin dhe funksionimin e mekanizmave për mbrojtjen e viktimave, përfshirë Mekanizmin e Koordinuar të Referimit (MKR).

Ligji nr. 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, që ndalon çdo formë diskriminimi, përfshirë diskriminimin gjinor dhe e obligon pushtetin vendor të marrë masa për promovimin e barazisë.

Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, i cili përcakton ofrimin e shërbimeve të specializuara për gratë dhe vajzat e dhunuara apo të marginalizuara në nivel lokal.

Ligji nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale”, i cili krijon mundësi për punësimin e grave në situata të pafavorshme përmes nxitjes së iniciativave vendore.

Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”, që sanksionon parimin e barazisë gjinore dhe garanton përfshirjen e vajzave të reja në jetën politike dhe sociale të bashkisë.

Kodi i Punës, me ndryshimet e vitit 2015 dhe 2020, që detyron institucionet publike vendore të sigurojnë mjedis pune pa ngacmime dhe diskriminim për shkak të gjinisë. Ligji nr. 104/2014 për sigurimet shoqërore, që përfshin të drejtën e lejes prindërore për burrat dhe nënat që rikthehen në punë.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që siguron ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe grupe të tjera të marginalizuara.

Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, që përcakton mbështetje për gratë viktimat të dhunës në familje dhe trafikimit përmes banesave sociale.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, e miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.06.2021, shërben si dokumenti udhëzues kryesor për këtë plan. Ajo orienton objektivat dhe masat strategjike për promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e dhunës me bazë gjinore, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë (si CEDAË, Konventa e Stambollit, Platforma e Pekinit, Objektivin e Zhvillit të qëndrueshëm 5, etj.).

Bashkia , nëpërmjet këtij Plani, harmonizon politikat vendore me këtë dokument kombëtar dhe merr përgjegjësi për zbatimin e tij në nivel lokal.

Ky kuadër ligjor dhe strategjik siguron themelin mbi të cilin Bashkia ndërton dhe zbaton politika të integruara për barazi gjinore, përfshirje dhe drejtësi sociale.

Plani është i harmonizuar me:

- Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), veçanërisht OZHQ 5 dhe 10
- Programin Kombëtar të Integritimit Evropian

Analiza e situatës gjinore ne territorin e bashkisë

Bashkia Kukës ndodhet në veri të Shqipërisë dhe kufizohet me Kosovën, duke pasur rëndësi strategjike për lidhjet ndërkufitare. Zona është kryesisht malore dhe rurale, me një ekonomi të bazuar në bujqësi, blegtori dhe aktivitete të vogla tregtare. Popullsia është në rënie për shkak të emigrimit dhe plakjes demografike. Shërbimet publike janë të përqendruara në qytetin e Kukësit, ndërsa zonat rurale përballen me akses të kufizuar ndaj arsimit, shëndetësisë dhe infrastrukturës. Megjithë sfidat, bashkia ka potencial të lartë për zhvillim turistik dhe bashkëpunim ndërkufitar.

Bashkia Kukës përfshin 15 njësi administrative:

Njesia Administrative	Tipologjia
Shishtavec	rural
Topojan	rural
Kalis	rural
Surroj	rural
Arrën	rural
Kolsh	rural
Bicaj	rural
Kukës	urban
Malzi	rural
Ujmisht	rural
Bushticë	rural
Gryk-Çajë	rural
Zapod	rural
Tërthore	rural
Shtiqën	rural

Burimi i të dhënave: INSTAT

Sipas të dhënave të fundit, bashkia ka një popullsi rreth 36,125 **banorë**, me një shpërndarje të popullsisë si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

Në aspektin social, bashkia është përballur me sfida që lidhen me migrimin e të rinjve, papunësinë, dhe nevojën për përmirësim të shërbimeve sociale, në veçanti për grupet më vulnerabël si gratë, të moshuarit, dhe personat me aftësi ndryshe.

Bashkia Kukës është e angazhuar në përmirësimin e qeverisjes vendore dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke promovuar vlera si transparenca, barazia dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Në këtë kuadër, hartimi i **Planit të Barazisë Gjinore** përfaqëson një hap të rëndësishëm në përpjekjet për të integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikatat dhe shërbimet publike të ofruara nga bashkia.

Demografia

Tabela më poshtë paraqet popullsinë e bashkisë sipas gjinisë:

Popullsia	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
Popullsia	18364	17761	36125	50.8	49.2


Burimi i të dhënave: INSTAT

Popullsia është e ndarë nëpër njësi administrative si më poshtë:

#	Njesia Administrative	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Arrën	106	81	187	56.7	43.3
2	Bicaj	2059	2007	4066	50.6	49.4
3	Bushtricë	284	264	548	51.8	48.2
4	Kolsh	553	505	1058	52.3	47.7
5	Kukës	7895	7748	15643	50.5	49.5
6	Malzi	830	786	1616	51.4	48.6
7	Zapod	717	717	1434	50	50
8	Shishtavec	1112	1125	2237	49.7	50.3
9	Shtiqën	1593	1470	3063	52.0	48.0
10	Surroj	303	276	579	52.3	47.7
11	Tërthore	1165	1146	2311	50.4	49.6
12	Topojan	548	514	1062	51.6	48.4
13	Ujëmisht	584	552	1136	51.4	48.6
14	Grykë Çajë	480	453	933	51.4	48.6
15	Kalis	135	117	252	53.6	46.4

Burimi i të dhënave: INSTAT

Në grafik:



Burimi i të dhënave: INSTAT

Analfabetizmi

Tabela më poshtë paraqet numrin e personave mbi 10 vjeç që dinë shkrim e lexim.

Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
Banorë që nuk dinë shkrim e këndim	269	466	735	36.6	63.4
Banorë mbi 10 vjeç	15434	14982	30416	50.7	49.3

Burimi i të dhënave: INSTAT

Nga gjithsej **30,416 banorë** mbi 10 vjeç në Bashkinë Kukës, **735 persona** rezultojnë se nuk dinë shkrim e lexim, që përbën rreth **2.4%** të popullsisë në këtë grupmoshë. Brenda këtij grupi, **466 janë gra** dhe **269 janë burra**, çka do të thotë se **63.4%** e personave që nuk dinë shkrim e lexim janë gra, ndërsa **36.6%** janë burra.

Krahasuar me përbërjen gjinore të popullsisë mbi 10 vjeç, ku **50.7%** janë burra dhe **49.3%** gra, vihet re një disproporcion në dëm të grave. Megjithëse gratë përfaqësojnë pak më pak se gjysmën e këtij grupi, ato përbëjnë një përqindje dukshëm më të lartë të personave që nuk zotërojnë aftësitë bazë të leximit dhe shkrimit.

Kjo tregon se gratë në Bashkinë Kukës janë më të ekspozuara ndaj analfabetizmit, veçanërisht në zonat rurale ose ndër moshat më të mëdha. Ky fenomen përbën një pengesë serioze për përfshirjen e tyre në jetën publike, ekonomike dhe institucionale. Mungesa e arsimit bazë ndikon negativisht në mundësitë për punësim, qasje në informacion dhe ushtrim të të drejtave qytetare.

Këto të dhëna theksojnë nevojën për politika dhe programe të posaçme të edukimit për të rritur, të cilat synojnë përfshirjen e grave që nuk kanë pasur mundësi të përfitojnë nga arsimi fillestar, duke kontribuar në uljen e pabarazive gjinore në këtë fushë.

Niveli Arsimor

Tabela më poshtë paraqet nivelin arsimor të popullatës.

Të dhënat tregojnë një shpërndarje të ndryshme gjinore në nivelet e ndryshme të arsimit, duke reflektuar tendenca sociale dhe sfida potenciale për barazinë gjinore në fushën e arsimit dhe më gjerë.

#	Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Asnjë nivel arsimor i përfunduar	45	91	136	33.1	66.9
2	Arsimi Fillor	491	903	1394	35.2	64.8
3	Shkollë 7/8/9 vjeçare	5678	6743	12421	45.7	54.3
4	Shkollë e mesme	5272	3229	8501	62.0	38.0
5	Bachelor	709	889	1598	44.4	55.6
6	Master ose Doktoraturë	913	1229	2142	42.6	57.4

Burimi i të dhënave: INSTAT

Të dhënat mbi nivelin arsimor të popullsisë në Bashkinë Kukës pasqyrojnë prirje të rëndësishme në shpërndarjen gjinore dhe japin një panoramë të qartë mbi sfidat dhe ndryshimet ndërmjet grave dhe burrave në qasjen ndaj arsimit.

Asnjë nivel arsimor i përfunduar – Nga gjithsej 136 persona pa asnjë nivel arsimimi, 66.9% janë gra dhe 33.1% burra. Gratë përbëjnë shumicën dërrmuese të kësaj kategorie, duke treguar se ato janë më të prekura nga mungesa e aksesit në arsim, ndoshta për shkak të zakoneve tradicionale, varfërisë, apo kushteve të vështira në zonat rurale.

Arsimi fillor – Nga 1,394 persona me vetëm arsimin fillor, 64.8% janë gra dhe 35.2% burra. Kjo sugjeron se një numër i konsiderueshëm i grave e ka ndërprerë shkollimin në këtë nivel, çka mund të jetë pasojë e barrierave ekonomike, sociale apo kulturore.


Arsimi 7/8/9-vjeçar – Ky është niveli më i përhapur, me 12,421 persona, ku 54.3% janë gra dhe 45.7% burra. Kjo tregon një përmirësim në qasjen në arsim të detyrueshëm për të dyja gjinitë, me një shpërndarje relativisht të balancuar që reflekton investimet në arsimin bazë.

Arsimi i mesëm – Nga 8,501 persona me këtë nivel arsimor, 62% janë burra dhe vetëm 38% gra. Kjo ulje në përfaqësimin e grave tregon se shumë vajza nuk arrijnë të vazhdojnë shkollimin pas arsimit të detyrueshëm, gjë që ndikon drejtpërdrejt në mundësitë e tyre për punësim dhe zhvillim personal.

Bachelor – Nga 1,598 persona me diplomë bachelor, 55.6% janë gra dhe 44.4% burra. Kjo përfaqëson një kthesë pozitive, pasi ato gra që vijojnë arsimin e mesëm kanë më shumë gjasa të arrijnë në arsimin e lartë krahasuar me burrat.

Master ose Doktoraturë – Nga 2,142 persona me këto diploma të avancuara, 57.4% janë gra dhe 42.6% burra. Gratë përbëjnë shumicën në arsimin më të lartë, çka tregon një tendencë të qartë për rritjen e rolit të tyre në fushën akademike dhe profesionale.

Përmbledhje – Të dhënat tregojnë një hendek gjinor të theksuar në nivelet e ulëta të arsimimit, ku gratë përballen me më shumë vështirësi. Megjithatë, në nivelet e larta arsimore, ato arrijnë të jenë më të përfaqësuara. Kjo tregon përmirësim të qasjes në arsim për vajzat në brezat më të rinj, por edhe nevojën për politika që mbështesin vijueshmërinë e shkollimit të vajzave pas arsimit bazë dhe mesëm, për të siguruar barazi të qëndrueshme në arsim dhe zhvillim.




Statusi martesor

Tabela më poshtë paraqet popullsinë mbi 10 vjeç sipas statusit martesor.

#	Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Beqar(e)	8918	6627	15545	57.4	42.6
2	I/e martuar	9140	9384	18524	49.3	50.7
3	I/e divorcuar ose i/e ndarë	67	125	192	34.9	65.1
4	I/e ve	239	1625	1864	12.8	87.2

Burimi i të dhënave: INSTAT



Shpërndarja e popullsisë sipas statusit martesor në Bashkinë Kukës tregon dallime të dukshme gjinore, të cilat lidhen me faktorë kulturorë, demografikë dhe socialë, duke ndikuar në mënyrë të ndryshme te gratë dhe burrat.

Në kategorinë **“beqar(e)”**, nga gjithsej 15,545 persona, 57.4% janë burra dhe 42.6% gra. Burrat përfaqësojnë shumicën e beqarëve, gjë që sugjeron se ata priren të martohen më vonë ose të mbeten më gjatë pa u martuar, në krahasim me gratë. Kjo mund të lidhet me pritshmëri të ndryshme sociale ndaj gjinive dhe rolit të tyre në familje.

Në kategorinë **“i/e martuar”**, shpërndarja është pothuajse e barabartë, me 49.3% burra dhe 50.7% gra nga gjithsej 18,524 persona. Kjo tregon një pjesëmarrje të ngjashme gjinore në martesë, edhe pse diferenca të vogla mund të vijnë nga faktorë si migrimi, ndarja ose vdekja e partnerëve.

Në kategorinë **“i/e divorcuar ose i/e ndarë”**, nga 192 persona, 65.1% janë gra dhe 34.9% burra. Gratë janë dukshëm më të përfaqësuara në këtë kategori, çka mund të lidhet me faktin se ato kanë më shumë gjasa të formalizojnë ndarjen ligjore, të mbajnë kujdestarinë e fëmijëve ose të mos rimartohen pas ndarjes.

Në kategorinë **“i/e ve”**, nga 1,864 persona, 87.2% janë gra dhe vetëm 12.8% burra. Ky dallim shumë i theksuar lidhet me jetëgjatësinë më të lartë të grave dhe faktin që gratë, pas humbjes së bashkëshortit, kanë më pak gjasa të rimartohen. Kjo kategori përfaqëson një grup vulnerabël, veçanërisht ndër gratë e moshuara, që përballen me sfida të vetmisë, mungesës së mbështetjes sociale dhe vështirësive ekonomike.


Të dhënat e mësipërme evidentojnë ndikimin që statusi martesor ka në përjetimet sociale të grave dhe burrave, duke theksuar nevojën për politika të ndjeshme gjinore, sidomos në mbështetje të grave të ve dhe të ndara, të cilat shpesh përballen me rrezik më të lartë të përjashtimit social dhe ekonomik.

Statusi i nënës

Tabela më poshtë tregon numrin e vajzave dhe grave që bëhen nëna, sipas grupmoshës.

Grupmosha	Kanë lindur	Nuk kanë lindur	Gjithsej	% kanë lindur	% NUK kanë lindur
15-24 vjeç	91	689	780	11.7	88.3
25-34 vjeç	501	226	727	68.9	31.1
35-44 vjeç	700	128	828	84.5	15.5
45-54 vjeç	1064	164	1228	86.6	13.4
55-64 vjeç	1412	196	1608	87.8	12.2
65-74 vjeç	970	101	1071	90.6	9.4
mbi 75 vjeç	573	38	611	93.8	6.2

Burimi i të dhënave: INSTAT



Të dhënat mbi lindshmërinë sipas grupmoshave në Bashkinë Kukës tregojnë një ndarje të qartë ndërmjet brezave dhe pasqyrojnë ndryshimet në sjelljet riprodhuese të grave në kohë.

Në grupmoshën **15–24 vjeç**, vetëm **11.7%** e vajzave kanë lindur fëmijë, ndërsa **88.3%** nuk kanë lindur. Kjo përqindje e ulët tregon se pjesa më e madhe e vajzave të reja nuk janë përfshirë ende në jetë prindërore, një tregues i ndikimit të faktorëve si ndjekja e arsimit, rritja e moshës së martesës dhe përqendrimi te vetëzhvillimi personal apo profesional.

Në grupmoshën **25–34 vjeç**, **68.9%** e grave kanë lindur, duke reflektuar se kjo është faza më aktive e jetës riprodhuese. Megjithatë, mbetet një përqindje e konsiderueshme (**31.1%**) e grave që nuk

kanë lindur ende, çka tregon për një zgjatje të kohës së vendimmarrjes për të pasur fëmijë dhe ndoshta ndikimin e faktorëve ekonomikë ose socialë.

Në grupmoshën **35–44 vjeç**, **84.5%** kanë lindur, dhe **15.5%** nuk kanë lindur. Kjo tregon se pjesa më e madhe e grave e kanë përmbushur funksionin riprodhues në këtë fazë, por gjithashtu vë në dukje se ekziston një numër jo i vogël i grave që ose nuk kanë pasur mundësi, ose kanë zgjedhur të mos kenë fëmijë.

Për grupmoshën **45–54 vjeç**, **86.6%** e grave kanë lindur dhe vetëm **13.4%** jo. Kjo është në përputhje me normat tradicionale, duke pasqyruar një brez në të cilin lindshmëria ishte më e lartë dhe prindërimi konsiderohej normë shoqërore.

Në grupmoshat **55–64 vjeç** dhe më tej, përqindja e grave që kanë lindur është gjithnjë në rritje: **87.8%** në moshën 55–64 vjeç, **90.6%** në 65–74 vjeç dhe **93.8%** tek ato mbi 75 vjeç. Këto të dhëna reflektojnë breza në të cilët lindja e fëmijëve ishte pjesë e pandashme e jetës së një gruaje dhe presioni social për të pasur fëmijë ishte shumë i lartë.


Në përmbledhje, të dhënat tregojnë një ndryshim të dukshëm ndërmjet brezave. Ndërsa në grupmoshat më të mëdha lindshmëria është thuajse universale, te gratë më të reja vihet re një shtyrje e moshës për lindje ose një ulje e prirjes për t'u bërë nënë. Ky fenomen pasqyron transformime të thella në normat gjinore, rritjen e përfshirjes së grave në arsim e punësim, si dhe nevojën për politika sociale që mbështesin planifikimin familjar, pajtimin e jetës profesionale me atë familjare dhe respektimin e zgjedhjeve individuale të grave në lidhje me prindërimin.

Frekuentimi i çerdhes

Tabela më poshtë paraqet numrin e fëmijëve që ndjekin çerdhen.

#	Emërtimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Ndjek cerdhen	299	299	598	50	50
2	NUK ndjek cerdhen	581	557	1138	51.1	48.9

Burimi i të dhënave: INSTAT



Të dhënat për ndjekjen e çerdhes në Bashkinë Kukës tregojnë se nga gjithsej 1,736 fëmijë, **598** ndjekin çerdhen (rreth **34.5%**), ndërsa **1,138** fëmijë nuk ndjekin (rreth **65.5%**). Kjo tregon se vetëm një në tre fëmijë përfitojnë nga ky shërbim, ndërsa pjesa më e madhe mbetet jashtë sistemit të kujdesit institucional në moshë të hershme.

Në aspektin gjinor, shpërndarja është thajse e barabartë. Ndër fëmijët që ndjekin çerdhen, **50%** janë djem dhe **50%** vajza, duke treguar se nuk ka prirje diskriminuese gjinore në përfshirjen në këtë shërbim. Edhe ndër ata që **nuk** ndjekin çerdhen, 51.1% janë djem dhe 48.9% vajza, duke ruajtur një balancë të afërt mes gjinive.

Megjithatë, përqindja e ulët e ndjekjes së çerdhes ngre shqetësime për qasjen në shërbimet e kujdesit ndaj fëmijëve të vegjël. Kjo mund të jetë rezultat i numrit të kufizuar të çerdheve publike, kostove ekonomike për familjet, mungesës së stafit të kualifikuar, ose normave kulturore që e shohin kujdesin për fëmijët si një përgjegjësi familjare, kryesisht e nënës.

Mungesa e aksesit në çerdhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në barazinë gjinore, pasi zakonisht gratë janë ato që marrin përsipër kujdesin për fëmijët e vegjël. Si rrjedhojë, ato përballen me kufizime në pjesëmarrjen në tregun e punës, në arsim ose në jetën publike. Zgjerimi i shërbimeve të çerdheve dhe përmirësimi i aksesit në to do të ndikonte pozitivisht në fuqizimin ekonomik dhe social të grave dhe familjeve në tërësi.

Frekuentimi i Kopshtit

Tabela me poshte paraqet numrin e femijeve te moshes 3-6 vjec qe ndjekin kopshtin

#	Frekuentimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Ndjek kopshtin	565	442	1007	56.1	43.9
2	NUK ndjek kopshtin	407	361	768	53.0	47.0

Burimi i të dhënave: INSTAT

Të dhënat mbi ndjekjen e kopshtit në Bashkinë Kukës tregojnë se nga gjithsej **1,775** fëmijë të moshës parashkollore, **1,007** ndjekin kopshtin (**56.7%**), ndërsa **768** nuk e ndjekin (**43.3%**). Ndër fëmijët që ndjekin kopshtin, **56.1%** janë djem dhe **43.9%** vajza. Kjo tregon se djemtë përfaqësohen më shumë në institucionet parashkollore sesa vajzat.

Po ashtu, edhe ndër ata që **nuk** ndjekin kopshtin, djemtë përbëjnë shumicën (53%), por diferenca me vajzat është më e vogël (47%). Megjithatë, mbetet e dukshme se vajzat janë pak më të prirura të mbeten jashtë sistemit të edukimit parashkollor.

Ky fakt ka pasoja në disa drejtime. Së pari, mungesa e vajzave në institucionet parashkollore mund të lidhet me norma kulturore që nuk e shohin shkollimin e hershëm si prioritet për to, ose me kushte ekonomike që i detyrojnë prindërit të bëjnë zgjedhje selektive në favor të djemve.

Së dyti, ndikimi reflektohet edhe te gratë dhe veçanërisht nënat, të cilat mbajnë barrën kryesore të kujdesit për fëmijët në këtë moshë. Kur fëmijët, sidomos vajzat, nuk ndjekin kopshtin, nënat kanë më pak hapësirë për të qenë aktive në tregun e punës apo për të ndjekur angazhime jashtë familjes. Kjo kufizon zhvillimin profesional të tyre dhe rrit varësinë ekonomike.

Në këtë mënyrë, një pjesëmarrje më e ulët e vajzave në edukimin parashkollor kontribuon në vazhdimësinë e një cikli të pabarazisë gjinore, ku edukimi i hershëm, punësimi dhe fuqizimi i grave ndërlidhen ngushtë me aksesin në shërbime publike për fëmijët.


Ky tregues duhet të merret në konsideratë në politikat vendore të barazisë gjinore, duke synuar rritjen e përfshirjes së vajzave në kopshte, zgjerimin e kapaciteteve të këtyre institucioneve dhe ofrimin e mbështetjes për prindërit që punojnë, në mënyrë që kujdesi për fëmijët të mos mbetet vetëm përgjegjësi e grave.

Persona me Aftësi të Kufizuar

Tabelat më poshtë tregojnë numrin e personave me aftësi të kufizuara në bashki, si në total ashtu edhe të ndarë sipas llojit të vështirësisë.

Grupmosha	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
5-14 vjec	27	13	40	67.5	32.5
15-64 vjec	395	451	846	46.7	53.3
mbi 65 vjec	357	495	852	41.9	58.1

Burimi i të dhënave: INSTAT



Të dhënat mbi personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Kukës tregojnë një prirje të qartë gjinore, ku gratë janë më të ekspozuara ndaj vështirësive funksionale, veçanërisht me rritjen e moshës. Kjo prirje ka ndikime të drejtpërdrejta në përfshirjen sociale dhe barazinë gjinore në nivel vendor.

Në grupmoshën **5-14 vjeç**, personat me aftësi të kufizuara janë kryesisht **djem** (67.5%), ndërsa vajzat përbëjnë vetëm 32.5%. Kjo tregon një shpërndarje të pabarabartë në këtë moshë të re, ndoshta për shkak të identifikimit më të hershëm të çrregullimeve tek djemtë ose vëmendjes më të shtuar që prindërit i kushtojnë zhvillimit të tyre.

Në grupmoshën **15-64 vjeç**, përqindja e **grave** (53.3%) e kalon atë të burrave (46.7%), ndërsa në grupmoshën **mbi 65 vjeç**, gratë përbëjnë shumicën e theksuar (**58.1%**). Kjo rritje graduale tregon ndikimin e faktorëve si jetëgjatësia më e lartë e grave, ekspozimi ndaj kushteve të vështira të punës dhe jetesës, si dhe barrierat e akumuluar shëndetësore dhe sociale gjatë jetës.

Kjo shpërndarje gjinore reflektohet edhe sipas **llojit të vështirësisë funksionale**:

- Në **vështirësinë për ecje**, që është dhe forma më e përhapur, **57.6%** e të prekurve janë gra.
- Në **dëgjim**, **55.6%** janë gra.
- Në **kujtesë**, **57%** janë gra.
- Në **kujdesin e përditshëm ndaj vetes**, **53.2%** janë gra.
- Në **komunikim**, **54.7%** janë gra.
- Edhe në **shikim**, ndonëse me një diferencë më të vogël, gratë përbëjnë shumicën (52.5%).


Kjo përbërje gjinore tregon se gratë me aftësi të kufizuara janë më të shumta dhe përballen me barriera të shumëfishta – shëndetësore, sociale dhe ekonomike. Ato rrezikojnë të përjetojnë **diskriminim të dyfishtë**: si gra dhe si persona me aftësi të kufizuara. Kjo e kufizon aksesin e tyre në shërbime publike, punësim, arsim dhe jetesë të pavarur.

Këto të dhëna tregojnë domosdoshmërinë për **masa të synuara nga Bashkia Kukës**, për të përfshirë gratë me aftësi të kufizuara në të gjitha politikat sociale dhe planifikimin gjinor. Kjo përfshin:

- sigurimin e infrastrukturës së aksesueshme,
- shërbime të dedikuara për kujdes personal dhe shëndetësor,
- mbështetje për punësim dhe përfshirje në komunitet,
- si dhe mbrojtje të veçantë nga diskriminimi dhe dhuna.

#	Lloji i vështirësisë	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Në shikim	305	337	642	47.5	52.5
2	Në dëgjim	214	268	482	44.4	55.6
3	Në ecje	501	681	1182	42.4	57.6
4	Kujtesë	179	237	416	43.0	57.0
5	Kujdesin e përditshëm ndaj vetes	221	251	472	46.8	53.2
6	Në komunikim	158	191	349	45.3	54.7

Burimi i të dhënave: INSTAT



Metodologjia

Përgatitja e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028 është zhvilluar në bazë të një metodologjie të kombinuar, që ndërthur analizën e thelluar të kontekstit lokal me orientimin nga kuadri ligjor dhe dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare. Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, i bazuar në të dhëna statistikore gjinore, në vlerësime institucionale dhe në praktikatat më të mira të planifikimit vendor të barazisë gjinore.

Hapi i parë metodologjik ka qenë shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe politik në të cilin do të mbështetet plani. Ky përfshinte, ndër të tjera, Ligjin nr. 9970 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, si dhe dokumente mbështetëse si Karta Evropiane për Barazinë Gjinore në Jetën Vendore dhe Agjenda 2030 e Kombeve të Bashkuara - Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ) 5, 10 dhe 16) Këto dokumente kanë orientuar konceptimin e objektivave, rolin e qeverisjes vendore dhe përgjegjësitë institucionale në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore.

Në vijim, u realizua një analizë e thelluar e situatës gjinore në territorin e bashkisë, e ndarë në dy shtylla: analiza territoriale dhe vlerësimi i kapaciteteve institucionale. Analiza territoriale u mbështet në të dhënat statistikore të përpunuara nga INSTAT dhe burime të tjera administrative, të cilat u ndanë sipas gjinisë dhe u trajtuan sipas tematikave kryesore: popullsia sipas grupmoshave, niveli arsimor, normat e analfabetizmit, statusi martesor, lidhja e grave me amësinë, dhe aksesin e fëmijëve në shërbimet e hershme të kujdesit (çerdhe dhe kopshte). U trajtuan edhe çështje që lidhen me personat me aftësi të kufizuar, si shpërndarja gjinore dhe lloji i kufizimit.

Analiza mori gjithashtu në konsideratë diferencat midis zonave urbane dhe rurale të territorit të bashkisë, për të kuptuar nëse sfidat gjinore janë homogjene apo të ndikuara nga konteksti gjeografik dhe social. Kjo analizë ndihmoi në identifikimin e nevojave të ndryshme në nivel njësie administrative dhe krijoi bazën për përshtatjen e ndërhyrjeve në planin e veprimit.

Në aspektin institucional, u analizua struktura ekzistuese dhe funksionaliteti i mekanizmave për barazinë gjinore brenda bashkisë. Konkretisht, u shqyrtua nëse bashkia kishte miratuar Kartën për Barazinë Gjinore, nëse Komisioni për Barazi Gjinore pranë Këshillit Bashkiak ishte funksional, dhe nëse Aleanca e Grave Këshilltare ishte aktive dhe me mbështetje buxhetore. Po ashtu, u vlerësua ekzistenca dhe roli i punonjësit të barazisë gjinore brenda administratës, pozicionimi i tij në strukturë (veçmas apo i lidhur me dhunën në familje), dhe çfarë roli dhe detyrash janë përcaktuar në përshkrimet e punës apo në rregulloren e brendshme të bashkisë.

Pjesë e rëndësishme e metodologjisë ka qenë edhe vlerësimi i kapacitetit për integrimin e perspektivës gjinore në politikatat dhe shërbimet publike, përmes ngritjes së një Komisioni të Administratës për Barazi Gjinore. U vlerësua nëse komisioni ekziston, është ngritur me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe nëse ka një rregullore funksionimi për të garantuar përfshirjen gjinore gjatë hartimit të buxhetit dhe planifikimit të shërbimeve.

Në vijim u shqyrtua praktika e mbledhjes së të dhënave me ndarje gjinore për çdo shërbim vendor. U evidentua se për disa shërbime ekziston mbledhje e rregullt e të dhënave, ndërsa për të tjera ka nevojë për përmirësim të kapaciteteve administrative dhe metodave të raportimit. Po ashtu, u

vlerësua nëse bashkia ka zbatuar ndonjëherë buxhetim me perspektivë gjinore dhe në çfarë mase janë alokuar fonde për aktivitete që kontribuojnë në barazinë gjinore.

Kjo metodologj ka mundësuar jo vetëm një kuptim të qartë të sfidave gjinore në territorin e bashkisë, por edhe krijimin e një plani realist, të matshëm dhe të përshtatshëm me burimet dhe kontekstin lokal të qeverisjes vendore.

Vizioni dhe objektivat strategjike

Në një periudhë trevjeçare, Bashkia synon të ndërtojë një realitet të prekshëm të barazisë gjinore, ku çdo vajzë dhe çdo djalë, çdo grua dhe çdo burrë, kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga zhvillimi lokal. Përmes zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028, do të konsolidohen strukturat institucionale, do të përmirësohet aksesueshmëria dhe cilësia e shërbimeve publike, do të zgjerohet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në vendimmarrje, dhe do të ndërtohen komunitete më të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj nevojave të ndryshme gjinore në çdo cep të territorit bashkiak. Vizioni i këtij plani është që barazia gjinore të mos mbetet një parim në letër, por të përkthehet në përfitime konkrete në jetën e përditshme të qytetarëve.

Qëllimet dhe objektivat strategjike

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkisë 2026–2028 ndërtohet mbi **qëllime strategjike**, të cilat përfaqësojnë shtyllat themelore të ndërhyrjes së bashkisë në promovimin e barazisë gjinore në nivel lokal. Këto qëllime janë të përkthyer në objektiva specifike dhe aktivitete konkrete, që mund të zbatohen, monitorohen dhe matën përgjatë një periudhe trevjeçare.

Qëllimi Strategjik 1 (Q1):

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Ky qëllim synon të konsolidojë qeverisjen vendore duke e trajtuar barazinë gjinore jo vetëm si një angazhim politik apo normativ, por si një komponent funksional dhe të domosdoshëm të mënyrës se si organizohen, menaxhohen dhe zhvillohet Bashkia. Në këtë kuadër, barazia gjinore nuk konceptohet si një qëllim i izoluar, por si një qasje ndërsektoriale që ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e proceseve vendimmarrëse, planifikuese, menaxheriale dhe raportuese të qeverisjes vendore.

Ky qëllim fokusohet në ndërtimin e një kulture institucionale që njeh, promovon dhe mbron të drejtat dhe nevojat e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë, duke garantuar përfaqësim të drejtë në strukturat e vendimmarrjes, përfshirje të balancuar në hartimin e politikave dhe qasje të njëjtë në shërbimet publike.

Për të arritur këtë qëllim, është e nevojshme që parimi i barazisë gjinore të integrohet sistematikisht në të gjitha dokumentet strategjike të bashkisë, në politikat dhe buxhetet vendore, në analizat dhe vlerësimet që zhvillohen nga institucionet publike, si dhe në mënyrën se si komunikohet dhe bashkëpunohet me qytetarët. Kjo përfshin zhvillimin e kapaciteteve institucionale, vendosjen e mekanizmave të brendshëm për monitorim dhe llogaridhënie, si dhe fuqizimin e rolit të aktorëve vendor, përfshirë këshillat bashkiakë, administratën vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin, në promovimin e barazisë gjinore si një element i padiskutueshëm i qeverisjes së mirë.

Qëllimi Strategjik 1 përfshin tre objektiva specifike:

- **1.1.** Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe transparent të raportimit publik mbi progresin për barazinë gjinore, duke përdorur të dhëna gjinore dhe platforma digjitale.
- **1.2.** Fuqizimi i mekanizmave institucionale lokale që merren me çështjet gjinore, përmes ngritjes së strukturave përfaqësuese, trajnimeve dhe rregulloreve funksionale.
- **1.3.** Nxitja dhe zgjerimi i pjesëmarrjes aktive të grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse dhe konsultimet me komunitetin.

Qëllimi Strategjik 2 (Q2):

Ky qëllim ka në qendër përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve përmes aksesit të barabartë në shërbime publike të përshtatura me realitetin gjinor dhe social të komunitetit. Ai synon që të gjitha shërbimet – si ato në arsim, shëndetësi, përkujdesje sociale, infrastrukturë, siguri publike, transport, dhe mbështetje për punësim – të projektohen dhe të zbatohen mbi baza që njohin dhe adresojnë në mënyrë të drejtë dhe efektive dallimet gjinore, ekonomike dhe territoriale mes qytetarëve.

Në mënyrë të veçantë, qëllimi thekson rëndësinë e ofrimit të shërbimeve që janë të aksesueshme, të përballueshme dhe të përshtatshme për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë – përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, minoritetet dhe grupet në situata të cenueshme. Parimi i gjithëpërfshirjes kërkon që askush të mos mbetet pas në qasjen ndaj shërbimeve, ndërsa ndjeshmëria gjinore kërkon që çdo ndërhyrje të marrë parasysh rolet, përgjegjësitë dhe barrierat me të cilat përballen burrat dhe gratë në mënyrë të ndryshme në shoqëri.

Ky qëllim kërkon gjithashtu ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale për të analizuar dhe përdorur të dhënat të ndara sipas gjinisë dhe grupmoshës në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe vendosjen e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të impaktit të tyre mbi barazinë gjinore dhe kohezionin social.

Qëllimi Strategjik 2 konkretizohet në katër objektiva specifikë:

- 2.1.** Garantimi i aksesit të barabartë dhe të balancuar territorialisht në shërbime publike të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes strukturave vendore dhe mbështetjes ekonomike.
- 2.2.** Rritja e efektivitetit të qasjes shumë-sektoriale për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore.
- 2.3.** Transformimi i lagjeve në hapësira të sigurta dhe të aksesueshme për të gjitha grupet gjinore, përmes planifikimit urban të ndjeshëm.
- 2.4.** Promovimi i përfshirjes së barabartë gjinore në jetën kulturore dhe sportive, përmes infrastrukturës, përmbytjes dhe pjesëmarrjes së barabartë.
- 2.5** Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga tranzicioni i gjelbër dhe transformimi digjital.



Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

Qëllimi Strategjik: 1

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Ky qëllim synon ta bëjë barazinë gjinore një pjesë përbërëse të kulturës institucionale të bashkisë, duke e integruar në strukturat, praktikat dhe komunikimin publik. Ai përfshin këta objektiva specifike:

Qëllimi strategjik 1:

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Objektivi Specifik (O1.1) Të krijohet një sistem i qëndrueshëm, transparent dhe periodik raportimi publik mbi progresin dhe angazhimet e Bashkisë për barazinë gjinore, përmes përdorimit të të dhënave gjinore, platformave digjitale dhe përfshirjes qytetare.					
Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.1.1 Publikimi i Planit të Veprimit në faqen e internetit të bashkisë dhe të KB-së.	2026	Njësia përgjegjëse për administrimin e faqes zyrtare Web të bashkisë; IT i/e bashkisë	Sekretariati i Këshillit Bashkiak, Komisioni i këshillit bashkiak për barazinë gjinore, aleanca e grave këshilltare	5,000 lekë (faqe web, staf teknik)	Plani i publikuar dhe qasja publike në faqen zyrtare
1.1.2 Hartimi i udhëzimeve dhe tabelave të treguesve për monitorim.	2026	Njësia e Planifikimit Strategjik dhe Njësia e performancës	Njësia përgjegjëse për hartimin e statistikave/performancës	90,000 lekë (dizajnim + printim udhëzues)	Dokument i përfunduar dhe shpërndarë në drejtoritë përkatëse
1.1.3 Trajnim për punonjësit mbi mbledhjen e të dhënave me tregues gjinorë.	2026 - 2028	Njësia e Burimeve Njerëzore	INSTAT, donatorë (UN Ëomen)	180,000 lekë (trajnerë + logjistikë)	Numri i punonjësve të trajnuar dhe vlerësimi pas-trajnimit
1.1.4 Krijimi i një platforme online të hapur për publikimin e statistikave dhe konsultime publike për masat për barazinë gjinore në Bashki	2026 - 2027	IT i/e bashkisë dhe Koordinatori për të drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	UNDP, AKSHI, Shoqëria Civile	450,000 lekë (zhvillim platforme, miëmbajtje 1 vit)	Platforma funksionale dhe numri i përdoruesve aktivë

1.1.5 Përfshirja në rubrikën përkatëse të seksionit për konsultime publike për buxhetimin dhe nxitjen e pjesëmarrjen gjinore	2026	Njësia përgjegjëse për hartimin e Buxhetit Afatmesëm dhe Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	Njësitë Administrative, Gra Këshilltare	60,000 lekë (takime + publikime informative)	Seksioni funksional dhe pjesë`marrje gjinore në konsultime
1.1.6 Kalendar Lokal dhe organizim i aktiviteteve për Ditët Ndërkombëtare të të Drejtave të Grave	Viti 2026 (i përsëritshëm çdo vit)	Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore & Drejtoria e shërbimeve sociale dhe kujdesit shoqëror	Shkolla, OJF vendore, media	120,000 lekë (aktivitete, printime, logjistikë)	Numri i aktiviteteve të organizuara sipas kalendarit
1.1.7 Sistem i integruar dixhital për mbledhjen dhe analizën gjinore të të dhënave në nivel lokal	2027 – 2028	IT dhe Përgjegjësit/drejtuesit e drejtorive/sectorëve në bashki	INSTAT, partnerë teknikë, ekspertë të fushës	700,000 lekë (zhvillim sistemi + trajnime)	Sistem funksional, numri i të dhënave të përpunuara gjinore
1.1.8 Krijimi i një indeksi lokal "Barometri bashkiak i barazisë" për të matur progresin gjinor në fusha si përfaqësimi, punësimi, shërbimet dhe dhuna me bazë gjinore.	2027 – 2028	Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore dhe Drejtoria e shërbimeve sociale dhe kujdesit shoqëror	IT dhe Përgjegjësit/drejtuesit e drejtorive/sectorëve në bashki	700,000 lekë (zhvillim i sistemit të dhënave + trajnim stafi)	Të dhënat e indeksuara në fusha si përfaqësim, punësim, shërbime, DHBGJ

Objektivi Specifik (O1.2) Të forcohen kapacitetet institucionale dhe strukturat organizative të Bashkisë për garantimin, koordinimin dhe integrimin e barazisë gjinore në të gjitha funksionet vendore.					
Aktivitete	Periodha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.2.1 Fuqizimi dhe rritja e eficiencës së Koordinatorit për të drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore (Ndarja e pozicionit në 2, njëri të jetë dedikuar çështjeve të BGJ)	2026-2028	Njësia përgjegjëse për Burimet Njerëzore & Kryetar i Bashkisë	Donatorë (UN Women, OSBE)	200,000 lekë (strukturim, materiale, orë pune)	Struktura funksionale dhe e pajisur me burime njerëzore të dedikuar për BGJ
1.2.2 Fuqizimi i Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel bashkie.	2026	Kryetari i Bashkisë	Drejtuesit e Drejtorive, Këshilli Bashkiak	80,000 lekë (mbledhje, dokumente, koordinim, orë pune)	Mbledhjet periodike të dokumentuara
1.2.3 Trajnim për anëtarët e Komisionit për Barazinë Gjinore (KBGJ) mbi buxhetimin gjinor.	2026	Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	UN Women, ekspertë të kontraktuar	100,000 lekë (trajnerë, logjistikë, materiale)	Numri i trajnimeve dhe përfshirja e anëtarëve
1.2.4 Program trajnimi për zyrtarët bashkiakë mbi BGJ dhe anti-diskriminimin sipas një kalendarit vjetor të miratuar.	2026 - 2028	Drejtorja e Burimeve Njerëzore & Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	Shkolla e Administratës Publike, OJF	300,000 lekë/vit (paketa trajnuese, fasilitatorë, certifikime)	Numri i trajnimeve të zhvilluara sipas kalendarit vjetor
1.2.5 Draftimi dhe miratimi një politike vendore kundër ngacmimit seksual dhe diskriminimit (PSEA)	2026	Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror	150.000 (ekspertizë për hartimin e PSEAs)	Drafti i PSEAs dhe konsultimi me stafin e bashkisë

Objektivi Specifik (O1.3) Të nxitet dhe zgjerohet pjesëmarrja aktive e grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse, konsultimet publike dhe hapësirat e dialogut me komunitetin, në nivel lokal.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.3.1 Takime informuese me administratorët shoqërorë mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në dëgjesa.	2026	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror & Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	Njësitë Administrative, Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	75,000 lekë (organizim, materiale, orë pune)	Numri i takimeve dhe pjesëmarrësve përfaqësues
1.3.2 Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere mbi rolet gjinore dhe dhunën me bazë gjinore në komunitete rurale dhe lagje urbane	2026 - 2028	Njësitë Administrative, Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	OJF vendore, shkolla, grupet e interesit	150,000 lekë (postera, aktivitete, facilitim, orë pune)	Numri i fushatave dhe zonat e mbuluara
1.3.3 Organizimi i fushatave të komunikimit gjinor me media vendore dhe shkolla.	2026 - 2028	Drejtoria e Komunikimit dhe Arsimit & Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	Media vendore, ZVA Bashkia, OJF	180,000 lekë (video, përmbajtje edukative, publikime)	Numri i fushatave të zhvilluara në media dhe shkolla
1.3.4 Organizimi i konsultimeve periodike dhe të rregullta me organizatat e grave dhe grupet në nevojë për problem, nevoja dhe sfida në ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve publike vendore.	2026 e në vijim	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror & Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	Zyra për Marrëdhënie me Komunitetin, OJF, grupime komunitare, përfaqësues të shërbimeve	120,000 lekë/vit (takime, raporte, koordinim, orë pune)	Numri i konsultimeve dhe temat e adresuara në shërbimet publike

Qëllimi strategjik 2:

Zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve publike gjithëpërfshirëse, të cilësisë së lartë dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, që adresojnë nevojat konkrete të grave dhe burrave në të gjitha zonat e territorit të Bashkisë.

Objektivi Specifik (O2.1) Të garantohet akses i barabartë dhe territorialisht i balancuar në shërbime publike cilësore dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes zhvillimit të strukturave vendore, mbështetjes ekonomike dhe ndërgjegjësimit komunitar.					
Aktivitete	Periusha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.1.1 Krijimi dhe funksionalizimi i strukturave të Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të rasteve (NJVNRR) për çdo NJA.	2026	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror & Kryetari	Këshilli Bashkiak, Njësitë Administrative, Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore, Policia, Shërbimi Shëndetësor	350,000 lekë (formim strukturash, trajnime, logjistikë, orë pune)	Numri i strukturave NJVNRR të ngritura dhe funksionale në NJA; Numri punonjësve social të punësuar
2.1.2 Krijimi i një programi vjetor të granteve të vogla për nxitjen e nismave sociale dhe bizneseve të vogla të grave (me vëmendje për zonat rurale dhe agroturizmin).	2026-2028	Njësia përgjegjëse për Zhvillimin Ekonomik dhe Bujqësisë	Agjencia e Zhvillimit Rajonal, Donatorë, OJF ekonomike	1,200,000 lekë/3 vite (fond për grante, promovim, ndihmë teknike, lehtësi fiskale)	Numri i granteve të dhëna; % e përfituesve nga zonat rurale
2.1.3 Formim profesional për vajzat dhe gratë në profile të kërkuara nga tregu lokal i punës	2026-2028	Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore dhe zyra vendore e AKPA	Qendra e formimit profesional (AKPA Kukës), Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror, OJF		Numri i vajzave dhe grave të trajnuara

2.1.4 Krijimi i qendrave komunitare për Gratë dhe Vajzat në çdo njësi administrative	2026-2027	Njësitë përgjegjëse për Infrastrukturën, shërbimet publike, & ndjekjen e investimeve në bashki	Njësitë Administrative, Arkitektë, Shoqata komunitare	700,000 lekë (mobilitet, ambiente, mirëmbajtje fillestare)	Numri i qendrave komunitare të hapura dhe frekuentimi i tyre
2.1.5 Zhvillimi i moduleve të ndërgjegjësimit mbi barazinë gjinore në bashkëpunim me ZVA dhe shkollat fillore	2026-2028	Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	ZVA , OJF edukative, mësues të përzgjedhur	180,000 lekë (modulim materiale, trajnim i mësuesve, monitorim)	Numri i moduleve të zhvilluara dhe numri i shkollave pjesëmarrëse
2.1.6 Ofrimi i këshillimit të karrierës për vajzat e djemtë dhe ndërgjegjësim për rolet dhe profesionet gjinore.	2026-2028	Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore dhe ZVA	Qendra sociale/multifunksionale në bashki, OJF	80,000 lekë (programe, trajnime)	Numri i djemve dhe vajzave të këshilluar

Objektivi Specifik (O2.2) Të forcohet reagimi institucional shumë-sektorial ndaj dhunës me bazë gjinore, përmes mekanizmave të koordinuar, qasjeve të ndjeshme gjinore dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë për viktimat në situata të zakonshme dhe emergjente.

Aktivitetet	Periusha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.2.1 Hartimi dhe miratimi i një protokollit të ndjeshëm gjinor për reagim në raste pandemie, fatkeqësi natyrore ose kriza civile	2025	Njësia përgjegjëse për shërbimet e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Shëndetësisë	Njësia përgjegjëse për Shërbimet Sociale; Qendra Shëndetësore, OJF, Ministria e Shëndetësisë	200,000 lekë (ekspertizë ligjore dhe sociale, konsultime)	Dokument protokollit i miratuar dhe i shpërndarë në strukturat vendore

2.2.2 Krijimi Strehëzës emergjente (72 orë) për viktimat e DHBGJ	2025 - 2027	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror	OJF, UNDP, UNICEF	fond nga grante, promocion,	Numri rasteve vajzave dhe grave të trajtuara / familjeve
2.2.3 Konsulencë ligjore falas për çështjet e diskriminimit gjinor.	2025–2027	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Kujdesit Shoqëror	Qendra Ligjore e Ndhmës Falas, OJF për të drejtat e grave	250,000 lekë/vit (pagesa për ekspertë, zyra këshillimi, informim publik)	Numri i rasteve të trajtuara dhe këshillimeve të ofruara

Objektivi Specifik (O2.3) Të përmirësohet siguria dhe cilësia e jetës në hapësirat publike urbane dhe rurale, përmes dizajnit të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe krijimit të mjediseve të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për gratë, vajzat dhe grupet në nevojë.					
Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.3.1 Zbatimi i nismes ‘Qytete të sigurta për grate, vajzat dhe grupet në nevojë’ në 3 lagje pilot përmes ndriçimit, sinjalistikës dhe shenjimit të hapësirave publike të sigurta	2026 - 2028	Njësia përgjegjëse për projektet e Urbanistikës dhe Infrastrukturës	Policia Bashkiake, OJF për të drejtat e grave, Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	1,000,000 lekë (projekt teknik, ndriçim, sinjalistikë, promovim, orë pune)	Numri i lagjeve të përfshira dhe ndërhyrjet infrastrukturore të realizuara

Objektivi Specifik (O2.4) Të sigurohet përfshirja e barabartë gjinore në jetën kulturore, letrare dhe sportive të komunitetit, përmes aksesit të drejtë në infrastrukturë, përmbajtje promovuese dhe programe pjesëmarrëse për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë.					
Aktivitete	Periusha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.4.1 Pasurimi i fondit të bibliotekës me libra që theksojnë rolin pozitiv të grave dhe burrave në fusha të ndryshme, si dhe promovimi i leximit të barabartë gjinor përmes klubeve të leximit	2026 - 2028	Njësia përgjegjëse Kulturën dhe Arsimin & Koordinatorin për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	Biblioteka e qytetit, ZVA, OJF	120,000 lekë (blerje librash, promovim, aktivitete, orë pune)	Numri i librave të blerë; numri i aktiviteteve të leximit
2.4.2 Promovimi i klubeve të leximit për barazi gjinore.	2026 - 2028	Biblioteka & Koordinatorin për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	Shkolla, OJF, klube rinore	80,000 lekë (materiale, lexim i drejtuar, takime diskutimi, orë pune)	Numri i klubeve funksionale, qendrat rinore dhe pjesëmarrësve (sipas gjinisë)
2.4.3 Sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë të vajzave dhe grave, djemve dhe burrave në veprimtari kulturore e sportive përmes përmirësimit të infrastrukturës dhe programeve të përshtatura të ndjeshme ndaj gjinisë.	2026 -2028	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit & Koordinatorin për të Drejtën e Informimit dhe Barazinë Gjinore	Klube sportive, OJF, Njësitë Administrative, komuniteti	900,000 lekë (rindërtime të vogla, programe, trajnime)	% e vajzave dhe grave, djemve burrave që marrin pjesë në aktivitete; numri i ambienteve të përshtatura



Monitorimi dhe raportimi

Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, i cili siguron ndjekjen në kohë reale të progresit, evidentimin e sfidave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimeve të ndërmarra. Ky sistem do të bazohet në një qasje të kombinuar: institucionale, participuese dhe të bazuar në të dhëna.

Qasja dhe parimet e monitorimit

Monitorimi do të jetë:

- **i strukturuar**, me përgjegjësi të qarta për çdo njësi zbatuese;
- **i bazuar në tregues të matshëm**, të përcaktuar për çdo aktivitet;
- **i hapur ndaj pjesëmarrjes së komunitetit dhe aktorëve jo publikë**, për të garantuar transparencën dhe përfshirjen.

Aktorët përgjegjës

- **Koordinatori për barazinë gjinore** do të luajë rolin koordinues dhe teknik për grumbullimin dhe analizën e të dhënave.
- **Komisioni për Barazinë Gjinore në Bashki (KBGJ)** do të ndjekë progresin në nivel strategjik dhe do të raportojë në Këshillin Bashkiak.
- **Drejtoritë dhe njësitë zbatuese përkatëse** janë përgjegjëse për dërgimin periodik të informacionit mbi zbatimin e aktiviteteve.

Treguesit e progresit

Për secilin aktivitet në plan janë përcaktuar tregues të qartë si: numri i trajnimeve të realizuara, pjesëmarrja gjinore në aktivitete, numri i strukturave të ngritura, përfshirja e komunitetit në konsultime, etj. Treguesit janë ndarë sipas gjinisë dhe, aty ku është e mundur, sipas grupmoshës dhe zonës (urbane/rurale).

Formatet e raportimit

Raportimi do të realizohet:

- **Çdo 6 muaj**, përmes një formati të thjeshtuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizës gjinore, që do të përdoret nga të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative.

- **Çdo vit**, përmes një raporti të përmbledhur vjetor mbi progresin e Planit, i cili do të publikohet në faqen e internetit të bashkisë dhe do t'u prezantohet këshilltarëve dhe komunitetit.
- Raporti vjetor do të përmbajë analiza të të dhënave, shembuj praktikë nga territori, si dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm.

Mbledhja e të dhënave, analiza dhe dixhitalizimi

Brenda vitit të parë të zbatimit, do të krijohet një regjistër dixhital për monitorimin dhe publikimin e statistikave gjinore dhe progresit të planit. Ky informacion do të jetë e hapur për publikun, duke mundësuar qasje transparente në të dhëna dhe nisma.

Vlerësimi ndërmjetës dhe përfundimtar

Në fund të vitit 2027 do të realizohet një vlerësim ndërmjetës, për të analizuar ritmin e zbatimit dhe për të bërë rregullime në plan, nëse është e nevojshme. Në vitin 2028, do të përgatitet raporti përfundimtar i zbatimit, që do të shërbejë si bazë për hartimin e planit të ardhshëm.